**VENDIM**
**Nr. 85, datë 22.2.2023**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË FIER, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE FIER, TË NJË PJESE TË TRUALLIT TË PASURISË NR. 3/656, ZONA KADASTRALE 8532, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 915, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 574, DATË 28.5.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "f", 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Fier, për Njësinë Administrative Fier, të një pjese të truallit të pasurisë nr. 3/656, zona kadastrale 8532, me sipërfaqe 1 422 (një mijë e katërqind e njëzet e dy) $m^2$, sipas formularit dhe planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën e transportit vendor.

2. Në pikën 1, të tabelës nr. 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 915, datë 11.11.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve te bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve", të ndryshuar, të dhënat e objekteve të pronës, me emërtimin "Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale të Qarkut Fier", të ndodhura mbi pasurinë nr. 3/656, zona kadastrale 8532, ndryshojnë sipas formularit, planimetrive dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 574, datë 28.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Fier, të qarkut të Fierit", të ndryshuar.

4. Bashkisë Fier i ndalohet ndryshimi i destinacionit, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim te të tretët i pasurive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Bashkia Fier dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
## (Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Fier

Fusha e perdorimit te Prones: Transport Vendor

Identifikoi: **Erdiola Dhanili,** *Specialiste e Menaxhimit te Pronave*
**Hyrisha Taçi,** *Specialiste e Menaxhimit te Pronave*

Supervizoi: **Erald Filipi,** *Drejtor i Menaxhimit te Pronave*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Armando Subashi,** *Kryetar I Bashkise*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 8532 FR-G-9 | 3/656 | Truall | Fier | 1422 | 168.2 | Transport Vendor | Bashkia Fier | Bashkia Fier | Pasuria 3/656 ka siperfaqe totale 1544 m2 sipas karteles se pasurise, prej te ciles 1422 m2 i kalojne ne pronesi Bashkise Fier. Ne kete pasuri ndodhen tre objekte ne pronesi te Bashkise Fier: Objekti Nr. 1 (Zyra) Sip. = 128.0 m², Objekti Nr. 2 (Ofiçine) Sip. = 27.9 m², Objekti Nr. 3 (Tualete) Sip. = 12.3 m² |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI : "BASHKIA FIER"** **DATE 03.11.2021** **QELLIMI: "REGJISTRIM PRONE"**

VENDNDODHJA
BASHKIA FIER | DVASHK / ZVASHK FIER | ZONA KADASTRALE 8532 | NUMRI PASURISE 3/656 | INDEKSI HARTES FR-G-9

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE: TRUALL | SIP.PASURISE: 1544m2 | SIP. GJURMES SE NDERTIMIT: | NUMRI I KATEVE | NUMRI I PEMEVE ____

X=464111.05
Y=4511738.14

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=464208.42
Y=4511738.14




**SHPJEGUES**

**PER NDARJE PASURIE:**

Parcela 3/656 vijon ne: (Sip. ne KPP=1544m2)
- → Parcela A, S=1422 m2
  Pronë e Bashkisë Fier
  Transferuar me Vendim Nr. 915 dt. 11.11.2015
- → Parcela B, në pronësi SHTET

KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE
Parcela 3/656, S =1522m2; Parcela A, S =1391m2; Parcela B, S =131m2

KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE
Parcela 3/656, S =1553m2; Parcela A, S=1422m2; Parcela B, S =131m2

X=464111.05
Y=4511672.11

**SH 1:500**

X=464208.42
Y=4511672.11

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | 3/422 | | |
| 2 | JUG | | | 3/655 | | |
| 3 | LINDJE | | | 3/377, 3/359 | | |
| 4 | PERENDIM | | | 3/460 | | |

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**

EMRI : Ing. Gjeo PETRIT JANI
LICENSA : NR. T 1097/1 DATE 25.01.2019
KOMPANIA : PERSON FIZIK
NIPT : L91930004B
NENSHKRIMI / VULA

**REALIZOI PER ASHK**

SPECIALISTI ______
DVASHK ______
NENSHKRIMI ______

**KONFIRMOI**

PERGJEGJESI/DREJTORI_____
NENSHKRIMI / VULA _______

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE:___________**

**Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;**

**PERCAKTIMI KUFIRIT:__________**

**Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;**

**SHENIME TE VECANTA:**

Për regjistrimin në pronësi të Bashkisë Fier, të një pjese të pasurisë 3/656, ZK 8532, me sipërfaqe A=1422m$^2$ si dhe objekteve brenda kësaj sipërfaqe: Objekti Nr. 1 (Zyra) S= 128.0 m$^2$, Objekti Nr. 2 (Ofiçine) S= 27.9 m$^2$, Objekti Nr. 3 (Tualete) S = 12.3 m$^2$, transferuar ne pronesi te saj me Vendim Nr. 915 dt. 11.11.2015.

**PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET**

EMRI___________
NENSHKRIMI _______

**Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale**

# PLANIMETRI E ZYRAVE




SIPERFAQE OBJEKTIT 128.0 m2

Punoi: Erdiola Dhanili

Hyrisha Taço

## PLANIMETRI E OFIÇINES




SIPERFAQE OBJEKTIT 27.9 m2

Punoi: Erdiola Dhanili

Hyrisha Taço

PLANIMETRI E TUALETEVE




SIPERFAQE OBJEKTIT 12.3 m2

Punoi: Erdiola Dhanili

Hyrisha Taço